Mirësevini – pastaj ndryshoni – propozimi i BE-së per vizat ndaj Ballkanit

Gerald Knaus dhe Alex Stiglmayer

16 korrik 2009

Dje, komisioni Europian propozoi që BE-ja t'i zhvendosë tri shtete të Ballkanit perëndimor – Maqedoninë, Malin e Zi dhe Serbinë - prej Listës së Zezë në Listën e Bardhë të Shengenit.

Nëse propozimi implementohet nga shtetet anëtare para këtij fundviti, ashtu si] është[planifikuar, kjo do të shënoj një hap të madh për rajonin e Ballkanit. Maqedonia ka qenë në cep të luftës civile në vitin 2001. Mali i Zi nuk u bë shtet i pavarur deri në vitin 2006. Për qytetarët e këtyre tri shteteve udhëtimi pa viza për në vendet e BE-së nga fillimii i vitit 2010 – për herë të parë qysh prej shpartallimit të Jugosllavisë socialiste – do të jetë shkak për festë. Për ata që ndërmorrën reforma, ky do të jetë sinjal që puna e tyre po shpërblehet.

Nuk ishte e lehtë të arrihet deri në këtë fazë. Janë dashur të implemntohen reforma thelbësore që të përmbushen 50 kushtet strikte që kishte vendosur Komisioni Europian: prej paisjës më të mirë të vendkalimeve kufitare, rritja e sigurisë së dokumenteve të udhëtimit e deri te bashkëpunimi më i mire policor në mes të vendeve të Ballkanit perendomor dhe BE-së. Dy ish-ministra të punëve të brendshme, ai i Italisë, Giuliano Amato dhe Gjermanisë, Otto Schily, të cilët njëkohësisht janë anëtarë të bordit këshillues të projektit të ESI-t 'Lista e Bardhë', na thanë gjatë mbledhjës së bordit në Stamboll këtë javë, që këto reforma e bëjnë Europën më të sigurtë dhe i bëjnë kërkesat për viza krejt të panevojshme. Kjo me të vërtetë është një situatë ku të gjithë përfitojnë.

Kjo është gjithashtu një kohë me shumë pasiguri ekonomike dhe politike në Ballkan. Në mënyrë që kushtëzimi i BE-së të sjell rezultate, Komisioni Europian duhet të jetë strikt në vendosjen e kushteve dhe i paanshëm kur vjen te vlerësimi i përmbushjës së këtyre kushteve, si dhe përmbushjës së premtimeve të vetë BE-së. Kjo do të jetë e nevojshme që BE-ja të ketë kredibilitet në këtë cështje.

Mirëpo tregimi nuk përfundon këtu.

Propozimi i Komisionit i lë dy shtete në listën e zezë - Shqipërinë dhe Bosnje-Hercegovinën. Kësaj liste i shton edhe Kosovën "nën rezolutën e këshillit të KB-së, 1244" si "entitet dhe autoritet territorial i pa njohur si shtet nga së paku një shtet anëtar i BE-së."

Kritikët me influencë në Parlamentin Europian, të udhëhequr nga Daniel Cohn Bendit dhe të tjerë nga partitë e gjelbërta, janë ankuar që BE-ja po i lë mbrapa disa nga shtetet më të brishta, ato të cilat kanë përjetuar tragjeditë më të rënda të dy dekadave të fundit. A është e arsyeshme moralisht t'ju lejohet serbëve të Beogradit të udhëtojnë pa viza ndërsa të afërmve të viktimave të Srebrenicës t'u mohohet e njëjta gjë?

Kritikët janë të brengosur me arsye: boshnjakët, shqiptarët dhe kosovarët mund ta gjejnë veten të burgosur përbrenda një enklave të re, edhe më të vogël se ajo e deritanishmja. Bosnja është duke u shkyer nga forca centrifugale ku kroatët dhe serbët e Bosnjës marrin pasaportat e vendeve fqinje dhe udhëtojnë pa viza, duke lënë kështu boshnjakët e izoluar. Një gazetë turke shkroi sot: "Bashkimi Europian i lë përsëri mbrapa myslimanët e Bosnës."

Duhet të kemi parasysh se rruga drejt udhëtimit pa viza është shtruar për të gjitha shtetet e Ballkanit perëndimor. Duke i vlerësuar të gjitha vendet në bazë të të njëjtave rregulla, Komisioni Europian ka bërë një propozim të paanshëm. Duke u bazuar në kushtet që ka vendosur BE-ja, vetëm qytetarët e Ballkanit të cilët kanë pasaporta biometrike do të mund të udhëtojnë pa viza. Mirëpo, për shkak të disa tenderave të dobët dhe vonesave të ndryshme, Bosnja e Hercegovina e ka shtyrë futjen në fuqi të pasaportave të tilla deri në fillim të vitit 2010! Shqipëria, edhe pse ja kalon Bosnjës në përmbushjen e kushteve, është duke ngecur mbrapa fqinjëve në futjën në fuqi të këtyre pasaportave.

Analistët e ESI-t javëve të fundit kanë analizuar në detaje se si po implementohen kushtet e BE-së nga vendet e Ballkanit. E mira është që nëse ka përqëndrim në këtë drejtim, brenda 12 muajve të ardhshëm Bosnja e Hercegovina si dhe Shqipëria mund të arrijnë nivelin e implementimit që Serbia ka sot.

Duke e mbajtur këtë në mend, ne ju bëjmë thirrje të gjitha vendeve të BE-së që t'u dërgojnë sinjale pozitive qytetarëve të të dy vendeve duke e futur Bosnjën dhe Shqipërinë në Listën e Bardhë të Shengenit brenda këtij viti, dhe të mbajnë peng aplikimin për udhëtim pa viza deri sa të përmbushen të gjitha kushtet e BE-së. Ne gjithashtu i bëjmë thirrje BE-së që ti përgjigjet të gjitha dyshimeve për njëanshmëri në vendime duke qenë plotësisht transparente gjatë marrjes së vendimeve.

Edhe pse qytetarët boshnjak dhe shqiptar do të zhgënjehen sot, ky vendim i BE-së ka qenë i pritur: ka javë të tëra që të gjithë e kanë ditur se deri në çfarë mase i kanë plotësuar kushtet e BE-së. Ata e dinë që nëse kushtet përmbushen, udhëtimi pa viza mundësohet. Boshnjakët gjithashtu e shohin se kanë plot shokë në Europë të cilët pa kurrëfarë hezitimi do të protestojnë në rast se dyshohet të jetë bërë diskriminim në proces.

Vetëm për Kosovarët nuk ka shpresë. Propozimi i BE-së për kosovarët është një tmerr. Kredibiliteti i BE-së në Kosovë do të vuaj prej këtij propozimi.

Shikoni se ku qëndron hipokrizia: për vite me radhë, kur i kthenin kosovarët prej vendeve të ndryshme të BE-së për në Kosovë, këta kosovarë konsideroheshin qytetarë serb, sipas ligjeve të Serbisë. Tani Komisioni Europian kërkon që Sërbia të krijojë pasaporta të veçanta për të gjithë qytetarët e Kosovës që duan të kenë një pasaportë të tillë . Këtyre pasaportave fillimisht do tu vendosej një 'K' e madhe e shtypit, mirëpo në minutën e fundit u vendos se një gjë e tillë do të dukej keq dhe u propozua që dallimi në mes të pasaportave duhet të jetë më pak i dukshëm. Kështuqë, propozimi thotë që pasaportat për kosovarët të lëshohen nga një zyrë e veçantë (*Koordinaciona uprava)* në Beograd, dhe qytetarët me pasaporta të tilla nuk do të lejohen të udhëtojnë pa viza.

Mendoni pak për pasojat e këtij propozimi. Për vite me rradhe BE-ja ka ligjëruar mbi rëndësinë e krijimit të një Kosove multi-etnike, ndërsa tani serbët e Kosovës duhet ta braktisin Kosovën dhe të regjistrohen si shtetas të Serbisë nëqoftëse dëshirojnë të marrin pasaporta që ju mundësojnë udhëtim pa viza për në Europë.

Disa kosovarë që e shohin marrjen e pasaportave Serbe nga qytetarët e kosovës si tradhëti, e kanë uruar këtë propozim si diçka pozitive. Ata e injorojnë faktin që vendimi për të përjashtuar kosovarët në këtë mënyrë diskriminuese është i "motivuar ekskluzivisht nga frika objektive që ka BE-ja për sigurinë në Kosovë", dhe jo nga mungesa e konsensusit brenda BE-së mbi statusin e Kosovës, siç u shpjegua nga Komisioni Europian. Përderisa moldavët, qipriotët e Turqisë apo argjentinasit mund të marrin pasaporta të vendeve të ndyshme anëtare të BE-së (në Rumani, Qipro apo Spanjë) bazuar në ligjet kombëtare të këtyre vendeve mbi shtetësinë, dhe pastaj të udhëtojnë pa viza nëpër Europë, Kosvarët që kanë shtetësi të dyfishtë nuk mund ta bëjnë të njëjtën gjë "për shak të sigurisë në vend e posaçërisht për shkak të potencialit për migrim ilegal" *(Komisioni Europian, Memorandum shpjegues).*

Cka është edhe më brengosëse, Komisioni as qe e përmend mundësinë për një proces të liberalizimit të vizave për Kosovën. Të gjithë kosovarët konsiderohen rrezik sigurie, ndërkohë që të gjithë serbët e Bosnjës mund të aplikojnë për pasaporta Serbe, të udhëtojnë në BE dhe të mos konsiderohen rrezik sigurie.

Nëse propozimi miratohet si i tillë, kjo do të nënçmoj gjithë mundin e deritanishëm të BE-së në Kosovë dhe mbyt shpresën që Kosova të ketë perspektivë Europiane. Nëse për ta vendosur Kosovën në Listen e Zezë të Shengenit nuk u dashka fare konsensusi i të gjitha shteteve të BE-së, atëherë njëjtë nuk do të nevojitet konsensus për ta futur atë në listën e bardhë të Shengenit.

Kushtëzimi "strikt dhe i paanshëm" ka funksionuar shumë mirë në Maqedoni, Serbi dhe Mal të Zi. Ka gjasë të jetë i suksesshëm edhe në Bosnje dhe Shqipëri (dhe është shumë e rëndësishme që tani shoqëria civile në BE dhe Ballkan të insistojë në transparencë të plotë gjatë vendim-marrjes në BE). Eshtë në interes të BE-së që ky proces të funksionoj edhe në Kosovë.

Propozimi i Komisionit është një hap i mirëpritur, por duhet të modifikohet në mënyrë që të parandalohen tensionet dhe problemet e reja në Ballkan.

Gerald Knaus dhe Alexandra Stiglmayer janë themelues dhe analistë të Iniciativës Europiane për Stabilitet (European Stability Initiative - ESI), organizatë hulmumtuese që ka monitoruar vazhdimisht procesin e liberalizimit të vizave në Ballkan. Për projektin e ESI-t shih www.esiweb.org/whitelistproject.

Për pjesën e projektit në gjuhën shqipe:
http://www.esiweb.org/pdf/schengen_white_list_project_ESI%201%20June%20letter%20ALB.pdf